



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 17.08.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.3) të Rregullores për Prokurim Publik të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 07.08.2026, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “EAE-NJAZ” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në zonat rurale”, Nr. i prokurimit- 632-26-5033-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-034-521, nxjerr:

V E N D I M

1. APROVOHET Pjesërisht si e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik “EAE-NJAZ” SH.P.K e dt.07.08.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në zonat rurale “, Nr. i prokurimit- 632-26-5033-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-034-521, kundër **DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMIT PËR KONTRATË**, të publikuar me datë 31.07.2026 të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. PËRMIRËSOHET Pjesërisht DOSJA E TENDERIT, e publikuar me datë: 31.07.2026

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëjë përmirësimin e pjesërishtëm të Dosjes së tenderit .

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik “EAE-NJAZ” SH.P.K e dt.07.08.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në zonat rurale “, Nr. i prokurimit- 632-26-5033-5-2-1.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Gjakovës, më datë 17.08.2026, gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim, ka konstatuar se:

• P R E T E N D I M I N R . 1 :

-Lidhur me kërkesën: *Operatori Ekonomik duhet te jetei pajisur me licenca valide për a) Prodhimin të betonit ose marreveshje për furnizim nga operatori i licencuar për prodhim të betonit, b) Shfytëzimi të rërës dhe zhavorrit ose Gurthyes, ose marrëveshje për furnizim nga operator i licencuar për shfytësim të rërës dhe zhavorrit ose Gurthyes, ky pretendim refuzohet si i pabazuar.*

Autoriteti Kontraktues vlerëson se Kërkesa si në Dosjen e tenderit për Pretendimin nr. 1 është përcaktuar në përputhje me nevojat reale dhe sipas kushteve në kontratë dhe si e tillë është e pabazuar.

Operatori Ekonomik duhet të respektoj kërkesat si në dosje të tenderit pasi janë punime që kanë të bëjnë kryesisht me shfrytëzimin e këtyre materialeve.

• **PRETENDIMI NR. 2:**

Lidhur me pajisjen *Cilinder hidraulike me gjemba që montohet në eskavator ose luge ngarkuese me kapacitet 400 deri 500 kg*, ky pretendim refuzohet si i pabazuar.

Autoriteti Kontraktues vlerëson se Kërkesa si në Dosjen e tenderit për Pretendimin nr. 2 është përcaktuar në përputhje me nevojat reale dhe sipas kushteve në kontratë dhe si e tillë është e pabazuar.

Kjo pajisje është e nevojshme për kryerjen e punimeve sipas këtij aktiviteti duke marr parasysh terrenin ku duhet të punohet.

• **PRETENDIMI NR.3:**

Lidhur me *Prerëse për armature më rrym 137*, ky pretendim aprovet dhe nga Prerese për armature më rryme mbetet vetëm Prerëse për armaturë.

• **PRETENDIMI NR.4:**

Lidhur me *Mikser për përzierjen e betonit*, ky pretendim refuzohet si i pabazuar.

• **PRETENDIMI NR.5:**

Lidhur me *Kovë që montohet në eskavator më sistem hidraulik për përzierjen e betonit deri 1m3*, ky pretendim refuzohet si i pabazuar,

Ky mjet është i nevojshëm duke pasur parasysh natyrën e punës dhe terrenin ku do të kryhet punimet sipas përshkrimit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Kopje:

Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Të gjitha palëve të interesuara;

FATON GUTAJ

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e paknaqur brenda afatit prej 10 ditëve mund të paraqesë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).